



UNIVERSITETI POLIS

Raport Vjetor
Viti Akademik 2024-2025

*Raporti Vjetor i
Universitetit POLIS për
veprimtarinë e kryer gjatë
vitit akademik 2024 – 2025,
në zbatim të Udhëzimit
Nr. 5, datë 19.02.2018
"Për përcaktimin e
elementëve përbërëse të
raportimit vjetor dhe afateve
për raportim të institucioneve
të arsimit të lartë", i
ndryshuar.*

Përmbajtje

HYRJE	3
PJESA A – SENATI AKADEMIK	4
Kreu A.1. – Realizueshmëria e Planit Strategjik Institucional	4
Kreu A.2. – Ndërkombëtarizimi (Projekte dhe Partneritete)	6
Kreu A.3. – Kërkimi Shkencor	7
Kreu A.4. – Të dhëna mbi programet e studimit	10
Kreu A.5. – Ndryshimet në statutin apo rregulloret dhe NJBSC-ja	13
Kreu A.6. – Personeli Akademik	17
Kreu A.7. – Të dhëna për gjurminin e studentëve që kanë përfunduar studimet ..	17
Kreu A.8. – Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë	21
Kreu A.10. – Të dhëna mbi studentët	22
Kreu A.9. – Vlerësime dhe rekomandime të mundshme për MAS	23
PJESA B – Bordi i Akreditimit	23
Kreu B.1. Struktura Organizative	23
Kreu B.2. Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm	24
Kreu B.3. Të dhëna për realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës	24
Kreu B.4. Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore	25
Kreu B.5. Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik	25
Kreu B.6. Konformiteti me Kodin e Cilësisë	27
ANEKSE	28

HYRJE

Universiteti POLIS është një institucion i themeluar me vendim të Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 35386 dt. 04.04.2006 dhe është i licensuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 698, dt. 11.10.2006. Në Tetor 2012, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 746 dt. 24.10.2012, i dha POLIS statusin "Universitet".

Që prej themelimit Universiteti POLIS ka përgatitur një raport vjetor të detajuar të aktivitetit të vet për çdo vit akademik dhe e ka depozituar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe Agjensisë së Akreditimit.

Këto raporte përmbajnë të dhëna përshkrimore dhe statistikore për aspekte të ndryshme të aktivitetit të institucionit sipas kësaj strukture:

Raporti është hartuar në përputhshmëri të plotë, duke përfshirë gjithë elementët e parashikuar në Udhëzimin e MAS Nr. 5, datë 19.02.2018, *(i ndryshuar)*.

Raporti vjetor i vitit akademik 2024 - 2025, pasohet nga shumë raportet të tjera vjetore që Universiteti POLIS, ka përcjellë çdo vit akademik që prej themelimit të tij. Ky është një tregues domethënës për kulturën e institucionit dhe ndjeshmërisë së tij ndaj të qenit një institucion sa më i hapur, komunikues dhe llogaridhënës ndaj komunitetit të tij dhe institucioneve partnere.

Qëllimi i hartimit të raportit:

1. Të informojë institucionet monitoruese, partnerët, stafin dhe studentët, si dhe publikun e gjerë për misionin e tij dhe përmbushjen e detyrimeve të veta ligjore duke dhënë një pasqyrë sa më të plotë dhe të saktë të institucionit.
2. Të sigurojë transparencë me institucionet monitoruese, partnerët, stafin dhe studentët, si dhe publikun e gjerë në lidhje me veprimtarinë e tij, programet e ofruara, rezultatet e arritura, gjendjen financiare si dhe aspekte të tjera të punës së institucionit.
3. Të forcojë përgjegjshmërinë sociale të institucionit duke ngritur një sistem të qëndrueshëm llogari-dhënie përpara studentëve dhe grupeve të tjera të interesit.

Raporti Vjetor i Universitetit POLIS, është hartuar bazuar në veprimtarinë e organeve drejtuese të institucionit, të njësive kryesore, të njësive bazë, të njësive administrative, dhe të studentëve.

Raporti është miratuar me vendim të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.

PJESA A – SENATI AKADEMIK

Kreu A.1. – Realizueshmëria e Planit Strategjik Institucional

a) Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.

Universiteti POLIS në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Institucional <https://universitetipolis.edu.al/a-glimpse-at-the-future/> gjatë vitit akademik 2024-2025, ka përmbushur me sukses një sërë synimesh të planifikura duke u fokusuar në konsolidimin e cilësisë së mësimdhënies, forcimin e kërkimit shkencor, si dhe zhvillimin e veprimtarive krijuese dhe inovative. Realizueshmëria e këtyre objektivave është monitoruar në mënyrë sistematike përmes strukturave përgjegjëse dhe mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Në fushën e mësimdhënies dhe nxënies, gjatë vitit akademik 2024-2025 janë ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e përmbajtjes dhe zbatimit të programeve të studimit, rritjen e komponentit praktik dhe përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies. Arritja e objektivave përkatëse është vlerësuar përmes raporteve periodike të vlerësimit të mësimdhënies dhe të nxënies, të hartuara mbi bazën e pyetësorëve të studentëve, vetëvlerësimit të stafit akademik dhe analizës së rezultateve të të nxënit.

Në drejtim të kërkimit shkencor dhe inovacionit, Universiteti POLIS, ka orientuar veprimtarinë e tij drejt rritjes së angazhimit të stafit akademik në kërkim, forcimit të bashkëpunimeve akademike dhe mbështetjes së iniciativave krijuese në përputhje me profilin institucional. Realizimi i objektivave monitorohet përmes raportit vjetor të kërkimit shkencor, i hartuar nga njësitë përgjegjëse për kërkimin dhe inovacionin, në koordinim me njësitë bazë dhe ato kryesore. Ky raport analizon tregues të tillë si publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte, aktivitetet kërkimore shkencore dhe kontributin e tyre në zhvillimin institucional, në përputhje me objektivat e planit strategjik për periudhën 2024-2025.

Gjithashtu vlen të theksohet realizimi i një sërë masave konkrete, të cilat dëshmojnë progresin në përmirësimin e cilësisë akademike, kërkimore dhe institucionale, në përputhje me profilin e universitetit në fushat e arkitekturës, planifikimit urban, dizajnit dhe mjedisit, teknologjisë, menaxhimit etj.

1. Përmirësimi i cilësisë së studentëve të pranuar si psh: rritje e përqindjes së studentëve të pranuar për herë të parë, rritje e mesatares akademike të studentëve të regjistruar në programet Bachelor dhe Master.

2. Ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti studentor si psh: rritje e numrit të studentëve pjesëmarrës në mobilitete Erasmus+ krahasuar me vitin pararendës, zgjerim i numrit të marrëveshjeve aktive të mobilitetit me universitete partnere në fushat përkatëse, rritje e numrit të krediteve të njohura pas përfundimit të mobiliteteve.

3. Rritja e numrit të studentëve të huaj si psh: rritje e numrit të studentëve incoming në kuadër të programeve të shkëmbimit, rritje e numrit të lëndëve të ofruara në gjuhë të huaj, hapja e programeve plotësisht në gjuhën angleze.

4. Konsolidimi i stafit akademik si psh: rritje e kapaciteteve akademike për stafin me kohë të plotë si marrja e gradës PhD, apo marrja e titujve profesor i asociuar nga 6 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë etj.

5. Aktivitetet me natyrë shkencore si psh: rritje e numrit të konferencave, workshopeve, ekspozitave, trajnimeve etj., rritje e numrit të pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në aktivitete shkencore.

6. Publikimet shkencore dhe kërkimore si psh: rritje e numrit të publikimeve në revista dhe konferenca ndërkombëtare, rritje e cilësisë së publikimeve (revista të indeksura, peer reviewed). Gjithashtu vlen të theksohet se gjatë vitit akademik 2024-2025 janë krijuar grupet Kërkimore Shkencore në nivel institucional duke bërë bashkë gjithë grupet e interesit.

7. Bashkëpunimi dhe projektet ndërkombëtare si psh: rritje e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit akademik dhe kërkimor, rritje e përfshirjes së stafit në projekte Erasmus +, e iniciativave të tjera ndërkombëtare si dhe pjesëmarrja me sukseset e Universitetit POLIS, në Aleancën Evropiane BAUHAUS4EU. Një iniciativë kjo që përfshin bashkëpunimin e 10 universiteteve evropiane nga nëntë shtete të ndryshme për të krijuar një "Universitet European" brenda kuadrit të thirrjes Erasmus+ nga Komisioni Evropian. Për katër vitet e ardhshme, Aleanca BAUHAUS4EU do të punojë për të krijuar një "kampus" të përbashkët evropian, duke ofruar mundësi arsimore inovative dhe një mobilitet gjithnjë e më të madh për studentët, stafin akademik dhe administrativ nga më shumë se 124,000 studentë dhe 10,000 staf të përfshirë në të.

Ky bashkëpunim synon gjithashtu të konsolidojë një institucion të qytetarëve evropianë që promovon përfshirjen, drejtësinë sociale dhe demokracinë liberale. Me një mbështetje financiare prej 14.4 milionë eurosh nga Erasmus+ 2024 për "Universitetet Evropiane", Aleanca është mundësuar të krijojë sinergji që do të ndihmojnë në internacionalizimin e kurikulave, inovacionin arsimor, përfshirjen dhe forcimin e qëndrueshmërisë.

8. Rankimi Ndërkombëtar i Universitetit POLIS si psh: Universiteti Polis është i pari universitet jopublik në Shqipëri që e kaloi me sukses procesin për rankimin në Times Higher Education, në kategorinë Impact Rankings 2025. Prej disa vitesh POLIS raporton pranë Times Higher Education, për rankimin në disa kategori si: World University Rankings, Interdisciplinary Rankings dhe Impact Rankings. Për dy të parat vijon të mbajë statusin e raportuesit, ndërsa në Impact Rankings 2025 POLIS u klasifikua në vend të 1500-të. Ndryshe nga renditja klasike që bazohet në performancën e universiteteve në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, THE Impact Rankings mat ndikimin ekonomik, social dhe mjedisor të universiteteve në raport me SDG (Sustainable Development Goals), duke theksuar rolin që universitetet luajnë në zhvillimin e qëndrueshëm. Për një universitet jo të madh, të profilizuar, nga një vend i vogël, kjo është një arritje e rëndësishme që flet jo vetëm për përkushtimin e universitetit për të pasur një impakt domethënës në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri por dhe për ambicien e tij për ta vlerësuar këtë impakt sipas standardeve më të larta ndërkombëtare.

9. Digjitalizimi i mësimdhënies dhe menaxhimit akademik si psh: rritje e përdorimit të platformave digjitale në procesin e mësimdhënies, rritja e transparencës dhe efikasitetit në menaxhimin akademik, përmirësimi i funksionaliteteve të sistemit të menaxhimit të studentëve PITAGORA, futja në përdorim për herë të parë të sistemit për kërkimin shkencor UCRIS etj.

10. Biblioteka dhe burimet akademike si psh: rritje e burimeve bibliotekare dhe digjitale, rrije e aksesit në databazën JSTORE, si dhe lancimi i platformës LIBIB e cila përfshin të gjitha kopertinat e librave fizikë që ndodhen në bibliotekën e Universitetit POLIS, si dhe të dhëna përshkrimore për secilin prej tyre me qëllim reduktimin e kohës që studentët duhet të shpenzojnë për shfletimin e literaturës fizike.

11. Universiteti POLIS ka përfunduar me sukses procesin e akreditimit për programet si vijon:

- i. Program i ciklit të dytë Master i Shkencave në "Menaxhim Mjedisor Urban".
- ii. Program i ciklit të dytë Master i Shkencave në "Dizajn të Aplikuar";
- iii. Program i ciklit të parë Bachelor në "Art dhe Dizajn"
- iv. Program i ciklit të parë Bachelor në "Administrim Biznesi"

*për më shumë shiko linkun <https://universitetipolis.edu.al/akreditimi/>

Gjithashtu, gjatë vitit akademik 2024-2025 Universiteti POLIS mori të gjitha masat e nevojshme, (për të cilat kemi raportur në mënyrë të vazhdueshme pranë MAS), për zhvillimin e mësimdhënies dhe mbylljen e vitit akademik brenda afatit të parashikuar në kalendarin e tij akademik.

Kreu A.2. – Ndërkombëtarizimi (Projekte dhe Partneritete)

b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.

Gjatë vitit akademik 2024-2025, Universiteti POLIS ka vazhduar me sukses përfshirjen në projekte të financuar nga BE, projekte të bashkëpunimit dypalësh apo dhe projekte të tjera. Për më shumë shiko tabelën si vijon:

Nr.	Tittle	Acronym	Lead partner	Strand	Status
1	Transport of Dangerous Goods – Modernization of Curricula and Development of Trainings for Professionals in the Western Balkans HEIs	DGTRANS	Universiteti i Mitrovices se Veriut (KS)	STRAND 2	2022-2025
2	Partnership for Promotion and Popularization of Electrical Mobility through Transformation and Modernization of WB HEIs Study Programs (PELMOB)	PELMOB	Universiteti i Mitrovices se Veriut (KS)	STRAND 2	2022-2025

3	International Engineering Competence Centres to push sustainable mobility development in Albania and Montenegro	INTEC	FH Joanneum Austri (AU)	STRAND 2	2023-2026
4	Enhancing curricula for the deployment of energy renewable energy sources in Western Balkans	ReZEB	University of Castilla La Mancha (ES)	STRAND 2	2023-2026
5	Improving University Quality Assurance Resilient Strategies Towards Excellence in WBs	QA-SURE	Western Balkan University (AL)	STRAND 1	2024-2026
6	Bridging the Digital Humanities and Educational Media divide in West Balkans	HOMO-DIGITALIS	LOGOS (AL)	STRAND 1	2024-2026
7	Merging fashion and tradition for sustainable style	COUTURE	UNIVERSUM College (KS)	STRAND 1	2024-2026
8	Urban Planning for Social Resilience in Urban Neighborhoods. Transformative Change through Civic Engagement	UPRUN	University of Dortmund (GE)	Financuar nga zyra Erasmus ne Gjermani (DAAD)	2024-2027
9	Adopting CCAM 2ZERO through ADRIION Programmed Partnerships	ADCCAM2ZERO	Universiteti i Patras	IPA Adrion	2024-2027
10	An Alliance for a Better Future European University for Resilient, Sustainable, Inclusive and Beautiful Regions	BAUHAUS4EU	Bauhaus University of Weimar	European University Alliance	2025-2029

* për më shumë shiko në linkun <https://universitetipolis.edu.al/projekte/>

Kreu A.3. – Kërkimi Shkencor

c) Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive;

- Politikat e kërkimit shkencor.

Universiteti POLIS, ka një direktivë "PËR PROMOVIMIN E PUBLIKIMEVE SHKENCORE", e cila rregullon veprimtaritë e parashikuara në nenin 5 të kësaj direktive për personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme në rastet e publikimit në emrin Universiteti POLIS. Nenet e kësaj direktive zbatohen edhe për personelin administrativ që angazhohet

në veprimtari akademike të përmendura në këtë direktivë. Në këtë mënyrë universiteti nxit, mbështet dhe promovon stafin i cili angazhohet në punë kërkimore shkencore.

- **Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor mbi mësimdhënien.**

Universiteti POLIS ka ndërtuar dhe zbaton një politikë të strukturuar dhe të institucionalizuar për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarisë krijuese. Vlerësimi i punimeve shkencore realizohet nëpërmjet Komisionit për "Nxitjen e Botimeve dhe Mbështetjen e Aktiviteteve Shkencore". Ky komision përbëhet nga drejtuesi dhe dy anëtarë. Në fillim të vitit akademik, Rektorati emëron anëtarët e Komisionit për një periudhë njëvjeçare.

Çdo vit akademik, Rektorati vendos për masën e mbështetjes për botimet shkencore. Pas vlerësimit të "Komisionit të Nxitjes së Botimeve dhe Mbështetjes së Veprimtarive Shkencore" dhe miratimit nga Rektorati, shpërblimi jepet duke shumëzuar koeficientin e mbështetjes me pikët sipas tabelës të përfshirë në direktivën "*Për promovimin e publikimeve shkencore*" e cila klasifikon pikët përkatëse të botimit shkencor dhe veprimtarive akademike për cdo kategori:

Në rast se në një publikim ka më shumë se një autor, shpërblimi ndahet ndërmjet autorëve që kanë kryer publikimin si më poshtë:

- për dy autorë: autori i parë do të marrë 60%, ndërsa autori i dytë do të marrë 40% të shpërblimit;
- për tre autorë: autori i parë do të marrë 50%, autori i dytë 30%, dhe autori i tretë 20% të shpërblimit;
- për më shumë se tre autorë: autori i parë do të marrë 40%, autori i dytë 30%, autori i tretë 20%, dhe 10% e mbetur do të pjesëtohet me numrin e autorëve të tjerë.

- **Produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;**

Gjatë vitit akademik 2024–2025, stafi akademik i Universitetit POLIS ka treguar një angazhim të qëndrueshëm dhe të strukturuar në aktivitete shkencore, kërkimore dhe akademike të cilësisë së lartë, në përputhje me profilin e institucionit dhe prioritetet strategjike në fushat e arkitekturës, planifikimit urban, shkencave kompjuterike, biznesit, menaxhimit, dizajnit dhe mjedisit.

Një numër i konsiderueshëm anëtarësh të stafit akademik kanë publikuar artikuj shkencorë në revista me indeks ndërkombëtar dhe kanë kontribuar me kapituj librash në bashkëpunim me botues ndërkombëtarë, duke reflektuar rritjen e cilësisë dhe dukshmërisë së kërkimit shkencor të Universitetit POLIS.

Tregues kryesorë të performancës:

- rritje e numrit të publikimeve shkencore në revista të indeksuara dhe peer-reviewed krahasuar me vitin pararendës;
- rritje e përqindjes së stafit akademik të përfshirë në aktivitete kërkimore dhe botime shkencore;
- rritje e numrit të kapitujve librash dhe monografive të botuara në bashkëpunim me botues ndërkombëtarë;
- rritje e pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca, seminare dhe workshop-e shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- përfshirje më e gjerë e stafit në rrjete akademike dhe profesionale ndërkombëtare.

Përveç veprimtarisë botuese, stafi akademik ka marrë pjesë aktive në konferenca, seminare dhe aktivitete shkencore, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij, duke prezantuar punime kërkimore dhe duke kontribuar në diskutime akademike bashkëkohore në nivel ndërkombëtar.

Këto arritje dëshmojnë përkushtimin e fakulteteve të Universitetit POLIS ndaj avancimit të njohurive, kërkimit të aplikuar dhe përfshirjes aktive në debatet akademike globale. Në tërësi, këto aktivitete kanë kontribuar në forcimin e reputacionit të Universitetit POLIS si një institucion i specializuar dhe i njohur akademikisht në fushat e studimit që mbulon.

Për më shumë shiko si më poshtë:

- Katalogun POLIS Press në linkun <https://press.universitetipolis.edu.al/about/>
- Revista Shkencore Forum A+P në linkun <https://press.universitetipolis.edu.al/forum-ap/>
- Revista Shkencore OMB në linkun <https://press.universitetipolis.edu.al/omb-scientific-journal/>
- TG Review në linkun <https://press.universitetipolis.edu.al/tg-review/>

Bashkëlidhur Raporti gjeni veprimtari shkencore të organizuara nga njësitë kryesore

- **Aneks 1** - aktivitete të zhvilluara fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn
- **Aneks 2** - aktivitete të zhvilluara fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban
- **Aneks 3** - aktivitete të zhvilluara fakulteti Kërkim dhe Zhvillim

- **Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor**

Biblioteka e U_POLIS ka një fond aktual prej 10, 400 titujsh në përputhje me programet që ofron duke qënë kështu një bibliotekë shumë e pasur për këto disiplina. Biblioteka ka literaturë të mjaftueshme dhe të shumëllojshme e cila i vjen në ndihmë studentëve që dëshirojnë të përdorin këto burime për realizimin e projekteve, kërkimeve shkencore dhe përgatitjen e tezave U_POLIS.

Në bibliotekë si rrjedhojë e shumëllojshmërisë që ofron janë përfshirë periodikë të ndryshëm të shkruar dhe elektronikë të revistave më influencuese shkencore të momentin.

Gjatë vitit akademik 2024 – 2025 Universiteti POLIS, vazhdon abonimin në një nga bibliotekat më të larmishme ndërkombëtare online **JSTOR e- library**.

Synohet pasurimi i vazhdueshëm i Bibliotekës nëpërmjet blerjeve, donacioneve nga partnerë (i.e UNIFE) dhe botimeve të stafit të U_POLIS, për më shumë informacion shiko në linkun https://universitetipolis.edu.al/biblo_polis/

Një objektiv tjetër shumë i rëndësishëm strategjik i POLIS është ai i fuqizimit të laboratorëve për zhvillimin e veprimtarive cilësore. U_POLIS aktualisht ka 7 laboratorë të shfrytëzueshëm për qëllime didaktike dhe kërkimore:

1. Laboratori i Mjedisit
2. Laboratori i GIS/CAD/SAP/ETABS/TEKLA
3. Laboratori i MAC
4. Laboratori i Eficiencës Energjitike
5. Laboratori i Prototipizimit
6. Laboratori i Shkencave Kompjuterike
7. Laboratori Innovation Factory
8. Laboratori i Modelimit
9. Laboratori Fab Lab
10. Laboratori PC Lab

Një pjesë e laboratorëve janë të akredituar dhe janë për shërbim ndaj të tretëve.

Ndërsa përse i përket një informacioni më të detajuar me të dhëna specifike për pajisjet laboratorike është raportuar nëpërmjet plotësimit të përvitshëm të raporteve të posaçme të kërkuara nga MAS si "Formulari i Vlerësimit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor" dhe kapacitetet pritëse. Sa më sipër kanë qënë dhe subjekt i verifikimit fizik gjatë vizitës së përvitshme për verifikimin e kapaciteteve pritëse.

Ndërkohe U_POLIS është investuar për zgjerimin e kapaciteteve fizike me një godinë të re, për të rritur cilësinë akademike, ndaj aktualisht procesi i mësimdhënies zhvillohet në dy GODINA.

Kreu A.4. – Të dhëna mbi programet e studimit

Programi i studimit	Baza ligjore		Statusi	Akreditimi
	Vendimi i Këshillit të Ministrave	Urdhri i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve		Urdhri i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve
Fakulteti i Arkitekturës dhe Dezajnit				
Master i Shkencave në Arkitekturë dhe Dizajn Urban 5 vjet Full-Time (300 ECTS)	Nr. 698, datë 11.10.2006	Nr. 102, datë 24.04.2009	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 227, datë 22.07.2009 Akreditim Periodik : Urdhër Nr. 268, datë 20.05.2016 Riakredituar me Vendim Nr.91, dt. 22.09.2023.
Bachelor në Art Dizajn 3 vjet Full-time (180 ECTS)	Nr. 406, datë 26.05.2010	Nr. 557, datë 09.12.2010	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013 Riakredituar me Vendim Nr. 1, dt. 01.02.2019 Vendim Nr. 119, datë 20.06.2025
Master Shkencor në Dizajn të Aplikuar. 2 vjet Full-time (120 ECTS)	Nr. 406,datë 26.05.2010	Nr. 557,datë 09.12.2010	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013 Riakredituar me Vendim Nr. 3, dt. 01.02.2019 Në pritje të Vendimit të Akreditimit
Mastera Profesional 2 vjet Part-Time (90 ECTS) me tre profile në:	Nr. 406,datë 26.05.2010	Nr. 587 datë 20.12.2010 Riorganizuar: Urdher Nr. 588 datë 20.12.2010 (MND)	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013 Riakredituar me Vendim Nr. 2, dt. 01.02.2019

Dezajn Parametrik në Arkitekturë Dezajn Strukturore-Estetik Dezajn Urban-Peisazh Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale 1.5 (një vit e gjysmë) më kohë të zgjatur (60 ECTS)		Riorganizuar: Urdhër Nr. 431 datë 11.11.2015 Riorganizuar: Urdhër nr. 438 date 12.11.2015 (i korigjuar) Riorganizuar: Urdher nr. 465 date 03.12.2015 (i korigjuar) Riorganizuar: Urdhër Nr. 377 datë 23.09.2021		Akredituar me Vendim Nr. 76, dt. 30.06.2023
Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi 3 vjet Full-time (180 ECTS)		Nr. 315, datë 21.07.2014	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr.270, dt.20.05.2016 Riakredituar me Vendim Nr. 217, dt. 15.12.2023.
Bachelor në Arkitekturë - Urbanistikë 4 vjet Full-time	VKM Nr. 698, datë 11.10.2006	Urdhër riorganizimi Nr. 102, datë 24.04.2009	Pezulluar	
Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi me dy profile a) Strukturë b) Gjeoteknikë 2 vjet Full-time (120 ECTS)		Urdhër Nr. 432 datë 12.11.2015	Aktive Jo aktive, Profili Gjeoteknik	Akredituar me Vendim Nr. 12, datë 30.03.2018 Riakredituar me Vendim Nr. 133, dt. 28.06.2023.
Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban				
Master Shkencor në Planifikim dhe Menaxhim Urban 5 vjet Full-time (300 ECTS)	Nr. 698, date 11.10.2006	Nr. 102, datë 24.04.2009	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 227, datë 22.07.2009 Akreditim periodik: Urdhër Nr.266, dt.20.05.2016 Riakredituar me Vendim Nr. 92, dt. 22.09.2023.

Bachelor në Studime Mjedisore 3 vjet me kohë të plotë (180 ECTS)	Nr. 406, datë 26.05.2010	Nr 557, datë 09.12.2010	JoAktive	Akredituar me Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013 Riakredituar me Vendim Nr. 4, dt. 01.02.2019
Bachelor në Administrim Biznes 3 vjet me kohë të plotë (180 ECTS)		Nr. 429, datë 18.07.2022	Aktive	Akredituar me Vendim Nr. 153, datë 14.11.2025
Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban 2 vjet me kohë të plotë (120 ECTS)	Nr. 406, datë 26.05.2010	Nr 557, datë 09.12.2010	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013 Riakredituar me Vendim Nr. 6, dt. 01.02.2019 Në pritje të Vendimit të Akreditimit
Mastera profesionale 2 vjet Part-time (90 ECTS) me tre profile në:	Nr. 406, datë 26.05.2010	Urdhër Nr.587, datë 20.12.2010	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013 Riakredituar me Vendim Nr. 5, dt. 01.02.2019 Akredituar me Vendim Nr. 77, dt. 30.06.2023.
Planifikim Hapësinor dhe Aplikime GIS Strehim dhe Zhvillim Toke Zhvillim Social Urban dhe Burime Njerëzore		Riorganizuar: Urdhër Nr.588 datë 20.12.2010 (MND) Riorganizuar: Urdhër nr. 431 date 11.11.2015 Riorganizuar: Urdhër Nr. 438 datë 12.11.2015 (i korigjuar)		
Master Profesional në Planifikim Territori dhe GIS 1.5 (një vit e gjysmë) me kohë të zgjatur (60 ECTS)		Riorganizuar: Urdhër Nr. 465 date 03.12.2015 (i korrigjuar) Riorganizuar: Urdhër Nr. 376 date 23.09.2021		
Master Profesional në Administrim Biznes 2 vite Part-time (90 ECTS) Master Shkencor në		Nr. 336, datë 16.08.2013 Riorganizuar: Urdhër Nr. 378 date	Aktive	Akreditim periodik: Urdhër Nr.269, dt.20.05.2016

Administrim Biznes 2 vite më kohë të zgjatur (120 ECTS)		23.09.2021		Riakredituar me Vendim Nr. 133, dt. 28.06.2024.
Bachelor në Planifikim Urban 4 vjet Full-time	VKM Nr. 698, datë 11.10.2006	Riorganizuar me Urdhër Nr. 102, datë 24.04.2009	Pezulluar	
Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim				
PhD në Arkitekturë dhe Planifikim Urban		Nr. 563, datë 19.11.2012	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 187, datë 15.05.2015 Akreditim periodik: Urdhër Nr.29, dt.03.03.2023
Bachelor në Shkenca Kompjuterike 3 vjet Full-time (180 ECTS)		Urdhër Nr. 815, date 21.12.2018	Aktive	Akreditim periodik: Urdhër Nr.28, dt.03.03.2023
Bachelor në Inxhinieri Software dhe Inteligjencë Artificiale 3 vjet Full-time (180 ECTS)		Urdhër Nr. 298, datë 02.07.2025	Aktive	Hapur për herë të parë në vitin akademik 2025- 2026
Program Profesional në Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike 2 vite Full-time (120 ECTS)		Urdher Nr. 814, datë 21.12.2018	Aktive	Akreditim periodik: Urdhër Nr.30, dt.22.04.2022
Program Profesional në Eficencë Energjetike 2 vite Full-time (120 ECTS)	Nr. 533, datë 08.05.2014	Nr. 315, datë 21.07.2014	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 242, datë 17.06.2015 Akreditim periodik: Urdhër Nr.51, dt.14.04.2023
Master Shkencor në Shkenca Kompjuterike 2 vite Full-time (120 ECTS)		Urdhër Nr. 352, datë 17.09.2021	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 149, datë 13.09.2024.
Master Ekzekutiv në Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore 1 vit Full-time (60 ECTS)		Urdhër Nr. 351, datë 17.09.2021	Aktive	Akredituar me Vendim Nr. 221, datë 14.12.2024

Kreu A.5. – Ndryshimet në statutin apo rregulloret dhe NJBSC-ja

- Ndryshimet në Statut dhe aktet e brendshme të universitetit

Universiteti POLIS për shkak të riemërtimit të njërive bazë në dy nga tre fakultet e tij, përkatësisht Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, si dhe fakulteti

Kërkim dhe Zhvillim, ka pësuar ndryshime edhe Shtojca 1 dhe Shtojca 2 Statutit të universitetit.

Për këtë proces është vënë në dijeni edhe MAS, sipas Vendimeve të Senatit Akademik, nr.8/1, datë 12.09.2025 i ndryshuar me vendim nr.1 datë 03.11.2025 si dhe Vendime të Bordit të Administrimit nr.18/1, datë 12.09.2025 i ndryshuar me vendim nr. 1, datë 03.11.2025.

Përditësime janë bërë edhe në aktet normative të brendshme të Universitetit POLIS si:

1. Rregullorja e Përgjithshme
2. Rregullorja Didaktike
3. Kodi i Etikës dhe akteve të tjera të brendshme lidhur me to, sikurse mund të gjenden edhe në faqen zyrtare të universitetit në linkun:

<https://universitetipolis.edu.al/akte-normative/>

- **Të dhëna mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e NJBSC-së**

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është thelbësore për ruajtjen e përsosmërisë akademike, efikasitetit operacional dhe një reputacioni të fortë brenda institucioneve të arsimit të lartë. Nëpërmjet standardizimit të proceseve, sigurimit të pajtueshmërisë me standardet e akreditimit të ASCAL dhe ato të përshkruara në ESG, si dhe duke nxitur përmirësimin e vazhdueshëm, kjo njësi luan një rol kryesor në rritjen e cilësisë në mësimdhënie, kërkim-shkencor dhe administrim. Nëpërmjet Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë nxitet llogaridhënia, mbështetet vendimmarrja e bazuar në të dhëna dhe përafrohen aktivitetet e universitetit me qëllimet strategjike të tij. Për më tepër, NJSBC-ja kontribuon në arritjen e rezultateve më të mira nga studentët, tërheq talentet e reja dhe mbron qëndrueshmërinë afatgjatë të institucionit, duke i bërë këta komponentë të domosdoshëm për arritjen e suksesit. Sigurimi i cilësisë mbetet kritik për aq kohë sa IAL-të zhvillohen duke përvetësuar praktika të reja të mësimdhënies dhe të të nxënit, zhvillohen modele të reja institucionale dhe tentojnë të zgjerojnë aksesin dhe barazinë në arsimin e lartë. Natyra dinamike e arsimit të lartë, veçanërisht në një kontekst gjithnjë e më të globalizuar, kërkon korniza të fuqishme të sigurimit të cilësisë që kanë aftësi të përshtaten ndaj ndryshimit duke ruajtur standarde të larta, në përputhje me parimet e përcaktuara në ESG. Bazuar në një rishikim gjithëpërfshirës të literaturës, rolet kryesore të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përfshijnë sigurimin e përputhshmërisë me standardet kombëtare të cilësisë, mbështetjen në arritjen e qëllimeve institucionale, përcaktimin dhe vlerësimin e rezultateve të të nxënit dhe rritjen e transparencës dhe vlerës së sistemeve të kualifikimit. Kjo njësi gjithashtu ka për detyrë të rrisë cilësinë e përgjithshme të ofertës akademike, të ofrojë mundësi për vetë-reflektim dhe vetëvlerësim dhe të mbështesë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes një cikli të vazhdueshëm përmirësimi. Për më tepër, ai ofron informacion thelbësor mbi cilësinë brenda dhe jashtë institucionit, nxit kënaqësinë e studentëve dhe mbështet proceset e vendimmarrjes të informuara brenda IAL-së. "Sigurimi i cilësisë është thelbësor për ruajtjen e këtyre vlerave në tri mënyra domethënëse: së pari, duke përforcuar vizionin se arsimi i lartë bazohet në këto vlera thelbësore; së dyti, duke shërbyer si një sistem kritik mbështetës për këto vlera në mijëra universitete dhe ofrues arsimor në zhvillim në mbarë botën; dhe së treti, duke vepruar si zë për studentët dhe shoqërinë, duke theksuar se si cilësia e arsimit të lartë është vizioni për integrimin e këtyre vlerave. Arsimi në Evropë udhëhiqet nga tre misione themelore: mësimi dhe mësimdhënia, kërkimi dhe shërbimi ndaj shoqërisë." (Eatson, 2021)

o *Korniza rregullatore e NJBSC-së*

Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë është një proces thelbësor që garanton që universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë përmbushin standardet e vendosura nga organet e akreditimit, autoritetet qeveritare dhe organizatat profesionale. Qëllimi kryesor i institucioneve të arsimit të lartë është ofrimi i një arsimi cilësor që përgatit studentët për tregun e punës dhe studime të mëtejshme, ndërsa njëkohësisht i pajis institucionet me

mjete dhe mekanizma efektive për përmirësim të vazhdueshëm. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në Universitetin POLIS mbështetet në tri shtylla kryesore, me qëllim garantimin e koherencës dhe efektivitetit. Duke u mbështetur në këto tri shtylla kryesore, NJBSC synon që aktiviteti saj të jetë në përputhje të plotë me praktikën më të mira dhe standardet ndërkombëtare, duke lehtësuar përmirësimin e vazhdueshëm si dhe integrimin në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Kjo qasje siguron që të gjitha përpjekjet në fushën e sigurimit të cilësisë të jenë kohezive dhe të mbështesin qëllimin kryesor të ruajtjes së standardeve të larta të cilësisë akademike dhe efikasitetit operacional. Tri shtyllat kryesore mbi të cilat NJBSC bazohet për të ushtruar aktivitetin e saj janë:

○ *Kërkesat ligjore të NJBSC-së*

Aktiviteti NJBSC kryhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore si më poshtë:

- *Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Nenet 46, 103, 104 dhe 106;*
- *Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë, i miratuar me VKM nr. 824, datë 24.12.2021, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë";*
- *Statuti i çdo institucioni të arsimit të lartë;*
- *Manuali i Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për sistemin e brendshëm të cilësisë.*

○ *Standardet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG)*

Në kuadër të Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane, veçanërisht në përputhje me Standardet I.2, I.3, I.4, I.5, I.6 dhe I.7, NJBSC synon të nxisë më tej aspektet e mëposhtme:

- Miratimi, monitorimi dhe rishikimi periodik i programeve (Standard I.2 -Pjesa 1, ESG_2015);
- Të nxënës, mësimdhënia dhe vlerësimi me në qendër studentin (Standardi I.3- ESG_2015);
- Monitorimi i vazhdueshëm dhe rishikimi periodik i programeve.

Kjo qasje siguron një sistem të fortë dhe gjithëpërfshirës të sigurimit të cilësisë, i cili jo vetëm mbështet qëllimet institucionale, por gjithashtu përputhet me integrimin rajonal në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Sipas kësaj strategjie, NJBSC në Universitetin POLIS kryen "vlerësimin e cilësisë" si në tërësinë institucionale ashtu edhe të programeve të studimit duke përdorur ciklin Plan-Do-Check-Act. Për më shumë detaje referohu aneksit "Strategjia e Zhvillimit dhe Strategjia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

○ *Funksioni dhe Roli NJBSC-së*

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) në Universitetin POLIS, funksionon në përputhje me përcaktimet e ligjit për arsimin e lartë në fuqi, akteve nënligjore në zbatim të tij, udhëzimeve të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, statutin e Universitetit POLIS, objektivat strategjike institucionale, si dhe standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë evropian (ESG) me qëllim përafrimin e praktikave me standardet e vendosura ndërkombëtare të cilësisë për të mbështetur përsosmërinë akademike.

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është konceptuar si një njësi e përhershme, e pavarur, e cila nëpërmjet funksionit të saj kryesor, vlerësimi të cilësisë, synon përmirësimin, rritjen e cilësisë, nxitjen dhe inkurajimin e aktorëve të cilët marrin pjesë në ofertën akademike në mënyrë që të shihet çdo aspekt me syrin e cilësisë, me krijimin dhe konsolidimin e kulturës së cilësisë në POLIS. Zhvillimi institucional, rritja e gamës së

ofertës akademike të POLIS, si dhe dalja e studentëve në tregun e punës, përbëjnë një sfidë serioze dhe vënë në provë cilësinë e programeve akademike dhe rezultateve të mësimnxënies. Pavarësisht emërtimeve të njësisë ndër vite, qëllimet e NJBSC kanë qenë të njëjta, fokusuar kryesisht në vlerësimin e performancës në procesin mësimor si për stafin akademik ashtu edhe për komponentë të tjerë të lidhur me procesin si bibliografia dhe materialet e studimit, infrastruktura dhe llogjistika. Sipas Vendimin e Senatit nr. 14, datë 26.08.2024, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga:

EMËR MBIEMËR	DETYRA
Dr. Emi Hoxholli	Kryetar
Prof. Asoc. Dr. Merita Guri	Anëtar
Dr. Endri Duro	Anëtar
Marsela Demaj	Anëtar
Xhoi Musliaka	Anëtar
Anjeza Dajzmaili	Anëtar
Fiona Pirushi	Anëtar (Përfaqësues i studentëve)
Gjergji Dushniku	Anëtar (Përfaqësues i ALUMNI)
Enxhi Cerpia	Anëtar (Përfaqësues Komuniteti i Biznesit)

Në përbërje të saj ka përfaqësues nga të tri fakultetet e Universitetit POLIS (FAD, FKZH, FPMU) dhe të tri ciklet e studimit (bachelor, master dhe doktoraturë), si dhe pjestarë nga grupet e interesit (student, alumni dhe komuniteti i biznesit). Ky miks bën të mundur realizimin me sukses të të gjithë fushave të veprimtarisë së NJSBC e cila është e rregulluar nga aktet e brendshme:

1. Rregullore e NJBSC;
2. Strategjia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë 2023-2027
3. Plani i Veprimit dhe Qëndrueshmërisë të NJBSC 2023-2027
4. Plani Vjetor i punës 2024-2025

Në funksion të përmbushjes së kërkesave që rrjedhin nga kuandri ligjor – rregullator, ESG dhe në përputhje me misionin, vizionin, objektivat strategjik të përcaktuar për periudhën afatmesme në Strategjinë e Zhvillimi të Universitetit, NJBSC ka parashikuar në Planin e Veprimit dhe Qëndrueshmërisë të NJBSC për 2023-2027, i cili bazohet në Strategjinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë 2023-2027 dhe Rregulloren e NJSBC, konkretisht në nenin 5 "Parimet themelore dhe veprimtaria e Njësies", aktivitetet të paraqitura në mënyrë të përmbledhur në grafikun e mëposhtëm:




Figura nr. 1 Paraqitje grafike e shtyllave kryesore të aktivitetit të NJBSC parakishuar në Planin e Veprimit dhe Qëndrueshmërisë 2023-2027

*Për më shumë rreth Aktiviteti Vjetor të NJBSC-së për vitin akademik 2024-2025, shiko **Aneks 4 – Raporti Vjetor i NjBSC-së 2024-2025**

Kreu A.6. – Personeli Akademik

Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulën/et që do të zhvillojë secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik 2024-2025.

Parashikimi i stafit akademik, lëndët e zhvilluara nga secili prej tyre dhe ngarkesa respektive përcaktohen në planet mësimore për secilin program studimi, hartuar nga Departamentet përgjegjëse dhe miratuar nga Senati Akademik.

Për vitin akademik 2024-2025, bashkëlidhur planet mësimore për të gjitha programet e studimit të U_POLIS janë përfshirë në **Aneks 5 - Planet Mësimore 2024-2025**.

Kreu A.7. – Të dhëna për gjurminin e studentëve që kanë përfunduar studimet

Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që IAL-të ofrojnë, të shoqëruar me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar: përqindjen e punësimit të të diplomuarve; përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe liqensohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar.

Universiteti POLIS synon t'u ofrojë studentëve trajnime akademike dhe praktike duke nxitur karakteristikat e lidhshme profesionale që kontribuojnë pozitivisht në zhvillimin e vendit dhe rajonit. Studentët marrin njohuri teorike dhe praktike të përafërsuara me

standardet më të larta bashkëkohore, duke lehtësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare të punës.

Universiteti Polis kryen aktivitete studimore, kërkimore, shkencore dhe praktike për të rritur efikasitetin e veprimtarisë akademike. Studentët njihen me inovacionin në fushat e tyre të studimit dhe me zhvillimet e tyre në rajon, duke synuar rritjen e hapësirës universitare në një platformë rajonale e pikë referimi në rajonin e Adriatikut dhe Jonit e më tej në Ballkan.

Gjatë studimeve, studentët inkurajohen të shtyjnë procesin e tyre të të menduarit drejt gjetjes së zgjidhjeve për problemet aktuale, përmes bashkëpunimeve të ndryshme projektsh me institucione, kompani dhe ndërmarrje të ndryshme.

Roli i studentëve në jetën akademike dhe shoqërore të universitetit, përmirësohet dhe mbështetet nga "Shoqata e Studentëve" dhe "Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës", të cilat së bashku arrijnë të gjallërojnë jetën shoqërore, diskutojnë për më tej karrierën përmes këshillimit profesional. Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi me këto njësi, si dhe me aktivitete të ndryshme që organizohen në kampus, plotësojnë të gjithë panoramën e jetës akademike, profesionale dhe sociale në POLIS, e më pas "Shoqata Alumni" pas diplomimit.

Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës është një njësi e posaçme dhe e pavarur për mbështetjen e studentëve, <https://universitetipolis.edu.al/zmskk-eventet/>¹.

Kjo njësi kryen funksion të dyfishtë. Së pari duke asistuar studentët gjatë kohës së ndjekjes së studimeve me anë të mbështetjes në jetën sociale studentore në POLIS, me aktivitetet kulturore, sportive e artistike vjetore, asistimin me ëorkshope në bashkëpunim me Senatin Studentor.

Së dyti, duke ndërmjetësuar hapësira për praktika profesionale dhe punësim. Këtë proces, ZMSKK e realizon duke mbajtur komunikime të vazhdueshme me biznese, kompani e institucione të ndryshme, duke realizuar marrëveshje bashkëpunimi, panairë karriere etj.

Panairi i Karrierës një traditë disa vjeçare në Universitetin Polis, sjell sëbashku ofertën dhe kërkesën në tregun e punës. Biznesi vendas dhe/ose i huaj ftohet të bashkohet në këtë iniciativë për të njohur nga afër potencialin e burimeve njerëzore të formuar në Universitetin POLIS, në një atmosferë mikëpritëse dhe gjithëpërfshirëse, për të promovuar bashkëpunimin midis universitetit dhe botës së sipërmarrjes.

Si një nga hapësirat më unike në shërbim të punësimit, ky event mbështet studentët dhe kompanitë, në kryqëzimin e fushave ndërdisiplinore të planifikimit, dizjanit, ndërtimit, teknologjisë dhe sipërmarrjes, duke shpërndarë njohuri mbi tregun e punës dhe sfidat që hasen.

Për vitin akademik 2024-2025, në Panairin e Karrierës morrën pjesë me shumë se 50 biznese kombëtare dhe ndërkombëtare. Këtë vit panairi mundësoi intervista të shumta. Në përfundimit të Panairit të Karrierës, ZMSKK akumulon të dhëna të deklaruara nga pjesëmarrësit me qellim për të garantuar një cilësi më të mirë të organizimeve në të ardhmen dhe jo vetëm.

Në përgjithësi, bizneset kishin nivele të ndryshme ndërveprimi me një numër të dukshëm që përfshinte rreth 25-30 aplikantë. Të dhënat pasqyrojnë një përhapje të mirë të angazhimit në të gjithë bizneset.

Në lidhje me individët e vlerësuar për punësim të mundshëm për rekrutim të mëtejshëm shohim se pjesa më e madhe e bizneseve gjetën midis 3-10 kandidatë për rekrutim të mëtejshëm dhe përqindje më të vogla vlerësuan se 1, 2, 6, dhe 20 individë janë konsideruar për rekrutim të mëtejshëm. Në përfundim të dhënat tregojnë se në varësi

¹ Zyra e Mbështetjes dhe Këshillimit të Karrierës tani e tutje do të përmendet me shkurtimin: ZMSKK

edhe të profileve të studimit, numri i individëve të përshtatshëm për tu futur në proces rekrutimi ndryshonte në organizata.

Kjo njësi ka krijuar një database që prej daljes së brezave të parë në tregun e punës dhe mban kontakte periodike me studentët duke përditësuar njëkohësisht këtë database. ZMSKK njek ecurinë profesionale të të diplomuarve, duke gjurmuar punësimin e tyre, arritjet, vështirësitë dhe përshtatjen me tregun e punës. Këto procese, kjo njësi i ndjek edhe në bashkëpunim me Shoqatën ALUMNI, (ish-studentëve të Universitetit - <https://universitetipolis.edu.al/alumni/> dhe shoqatën AUA (Unioni i Arkitektëve, Urbanistëve dhe Planifikuesve Urbanë); nëpërmjet të cilave mundëson njohjen e dinamikave të tregut të punës, proceset e lobimit dhe mbrojtjes së të drejtave profesionale, si dhe procedurat e provimeve të shtetit apo liçensimit.

Qëllimi ZMSKK si strukturë në vetvete është i orientuar drejt mbajtjes së kontaktit të vazhdueshëm si dhe dhënies së informacionit shumëdrejtmesh. Informacioni që kjo zyrë synon fillon që me azhurnimin e kontakteve të Alumni, të cilat shërbejnë për komunikim më të drejtpërdrejtë me ta. Së fundmi Universiteti Polis po punon për ngritjen e një website për lidhjen e kontakteve të ALUMNI për përdorim të brendshëm.

Më tej, ZMSKK përmbledh informacion për studime të mëtejshme, programe të ndryshme, orientim për karrierën ose orientimin profesional si dhe këshillim individual ose në grup. Për më tepër kjo njësi bashkëpunon ngushtë edhe me drejtuesit e Shoqatës Studentore POLIS, nëpërmjet të cilëve është arritur krijimi i një marrëdhënie të ngushtë dhe tepër bashkëpunuese për përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve të ofruara nga universiteti për studentët.

Veprimtaritë dhe detyrat kryesore të Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës janë:


- ✓ Informimi i studentëve dhe sigurimi i transparencës së plotë për çështjet e aspektet akademike, mësimore dhe shkencore si dhe me të drejtat e detyrat e tyre;
- ✓ Orientimi i studentëve në shkollimin dhe gjatë shkollimit për zgjedhjen e fushave formuese specifike dhe mundësive të formimit që ofron universiteti;
- ✓ Orientimi dhe njohja e studentëve me tregun e punës në përgjithësi dhe mundësitë e veçanta e të momentit për punësimin duke ndërmjetësuar këtë proces;
- ✓ Të mbajë kontakte individuale me studentët edhe pas diplomimit e punësimit të tyre duke marrë në mënyrë të vazhduar feedback-un e tyre;
- ✓ Të kryejë studime të përditësuara të tregut të punës dhe identifikimin e kërkesave të tij dhe t'i vërë ato në dispozicion të studentëve;
- ✓ Rregullon dhe siguron përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, në proceset e aktiviteteve kryesore që lidhen me mësimdhënien dhe aktiviteteve të tjera kërkimore e zhvilluese si dhe shërbimet që u ofrohen;
- ✓ Trainim për mënyra aplikimi në institucione të ndryshme dhe përgatitje të dokumentacionit aplikues, etj.

Informacion akumulues mbi rezultatet e studentëve të diplomuar dhe raportit të punësimit.


Duke filluar nga muaji korrik dhe duke vazhduar deri në shtator, ZMSKK mbledh të dhëna të vetë-raportuara nga të sapodiplomuarit përmes një pyetësi gjithëpërfshirës që ZMSKK përdor për gjenerimin e informacionit nga ALUMNI. Ky sondazh shërben si një instrument kyç për gjurmimin dhe analizimin e statusit të punësimit dhe rrugët e karrierës të diplomuarve tanë.

Konkretisht, në vitin akademik 2024-2025, 95% e të diplomuarve nga të gjitha programet e studimit në Universitetin POLIS, morrën pjesë në zhvillimin e pyetësorit. Një ndër faktorët thelbësor të cilësisë së punësimit të tyre është punësimi i tyre në raport me studimet e kryera, në rastin e studentëve të POLIS, të diplomuar deri në mbyllje të vitit akademik 2024-2025, sipas rezultateve të pyetësorit rezultojnë se 96 % e studentëve janë të punësuar dhe 90% e tyre janë të punësuar në pozicion pune që përputhet me diplomën e fituar. Ky korrelacion i lartë midis arsimit dhe punësimit nënvizon vlerën e programeve tona akademike dhe gatishmërinë e të diplomuarve tanë për të përmbushur kërkesat e industrisë, duke rritur më tej reputacionin e institucionit tonë dhe efikasitetin e shërbimeve tona të mbështetjes në karrierë.


Raporti i Studentëve që iu përgjigjën pyetësorit



Statusi i Punësimit



Punësimi në raport me profesionin



■ Përgjigjur Pyetësorit ■ Pa Përgjigje ■ Të Punësuar ■ Të Pa punësuar ■ Të Punësuar në Profesion ■ Të Punësuar jo në profesion

Figure 4: Tabela Përmbledhëse e situatës së punësimit të studentëve të diplomuar deri në mbyllje të vitit akademik 2024-2025, sipas përqindjes së studentëve që iu përgjigjën pyetësorit, punësimit dhe punësimit në përputhje me diplomën

Si më poshtë jepen të dhëna mbi numrin e studentëve të diplomuar gjatë vitit akademik 2024-2025, sipas programeve të studimit.

Departamenti	Lloji i Diplomes	Programi i Studimit	Nr.i studentëve të diplomuar
Departamenti Art dhe Dizajn	Bachelor	Art dhe Dizajn	81
Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri Ndërtimi	Bachelor	Inxhinieri Ndërtimi	28
Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri Ndërtimi	Master i shkencave(PI)	Arkitekturë dhe Dizajn Urban	76
Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri Ndërtimi	Master i shkencave	Inxhinieri Ndërtimi me profile: a. Strukturë;	19
Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri Ndërtimi	Master profesional	Arkitekture Dixhitale	4
Departamenti Art dhe Dizajn	Master i shkencave	Dizajn i Aplikuar	20
Departamenti Planifikim dhe Mjedis	Master i shkencave(PI)	Planifikim dhe Menaxhim Urban	11
Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit:	Master profesional	Planifikim Hapesinor dhe GIS	5
Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit:	Bachelor	Administrim Biznesi	9
Departamenti Planifikim dhe Mjedis	Master i shkencave	Menaxhim Mjedisor Urban	16
Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit:	Master i shkencave	Administrim Biznesi	5
Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Bachelor	Shkenca Kompjuterike	85
Departamenti i Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	Diplomë profesionale	Eficientë Energjitike	6
Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Diplomë profesionale	Mirëmbajtje Rrjetesh Kompjuterike	3
Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Master i shkencave	Shkenca Kompjuterike	13
Departamenti i Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	Master i shkencave	Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore	11
Departamenti i Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	Doktoratë	Arkitekturë dhe Planifikim Urban	8

Raporti i të diplomuarve në lidhje me punësimin, punësimi në profesion dhe raporti me sektorin publik/ privat




Figure 5: Tabela Përmbledhëse e situatës së punësimit të studentëve të diplomuar sipas cikleve të studimit deri në mbyllje të vitit akademik 2024-2025

Këto të dhëna japin një pamje të qartë të suksesit në përgatitjen e të diplomuarve për tregun e punës, veçanërisht në punësimin në sektorin privat. Lidhja ndërmjet arsimit dhe punësimit është e fortë, veçanërisht në programet e masterit profesional dhe shkencor. Mbizotërimi i vendeve të punës në sektorin privat mund të tregojë fusha ku mund të zhvillohen partneritete ose fokus të mëtejshëm për të rritur angazhimin e sektorit publik, veçanërisht për programet si programet e Bachelor dhe të Shkollës Profesionale.

Kreu A.8. – Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë

Studentët janë të organizuar në mënyrë të pavarur në Senatin Studentor ku zgjedhin me vullnet të lirë përfaqësuesit e tyre (me të drejtë për ushtrimin e kësaj detyre përgjatë 2 viteve), në proporcion me numrin e studentëve nëpër klasa, përafërsisht 1 përfaqësues për 30-40 studentë. Struktura dhe organizimi i Senatit Studentor paraqitet në linkun: <https://universitetipolis.edu.al/senati-studentor-2/>

Studentët përfaqësohen gjithashtu në **Senatin Akademik të Universitetit**, i cili është organi më i lartë drejtues i institucionit, në masën 15.8% (3/19) <https://universitetipolis.edu.al/senati-akademik/>

Ndërsa në **Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë**; nga 9 anëtarë të NJSBC, 1 është përfaqësues i studentëve aktualë dhe 1 i atyre të diplomuar (Alumni), duke mbuluar 22.2% të antarëve të njësisë <https://universitetipolis.edu.al/struktura-te-tjera-te-pavarura/>

Brenda Strukturës së **Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës**, aktualisht gjysma e anëtarëve përfaqësohet nga Alumni të cilët ndjekin së brendshmi mbarëvajtjen dhe problematikat profesionale.

Në Strukturën e POLIS, funksionojnë ehe **Klubet e pavarura** të cilat ndajnë sëbashku filozofinë e Universitetit, mbështetur në vlerat e misionin e universitetit dhe bashkëpunojnë sëbashku për ngritjen e një jete sociale dhe forcimin e komunitetit "Polis-ian". Klubet Studentore ri-organizohen çdo fillim viti akademik, ku studentët me anë të plotësimit të formularit organizohen në klubin përkatës për të zhvilluar interesat e tyre, dhe sëbashku bashkëpunojnë brenda kategorive: Klube Sportive, Artistike dhe Social-Kulturore, për të realizuar aktivitete të ndryshme gjatë vitit.

Aktivitetet e parashikuara për rritjen e frymës së grupit në komunitetin studentor të U_POLIS janë të parashikuara në çdo fillim viti nëpërmjet një programi vjetor të hartuar nga ZMSKK dhe Komuniteti Studentor. Llojet e aktiviteteve të parashikuara dhe të përgjatë vitit akademik 2024-2025, mund t'i shohim në linkun <https://universitetipolis.edu.al/zmskk-eventet/>

Broshura Alumni

Nga komunikimet me Alumni, por edhe ndjekjes në forma të tjera të karrierës së tyre profesionale, disa nga eksperiencat më domethënëse dhe rrugëtime të tyre, bëhen pjesë e një Broshure të Posaçme, e cila publikohet 1 herë në 2-3 vite. Për më shumë shiko Broshurën Alumni në linkun: https://universitetipolis.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/Alumni-Brochure_2017-2021-1.pdf

Kjo përmbledhje bëhet baza për krijimin e formave të tjera të bashkëpunimit mes të diplomuarve dhe studenteve aktuale të POLIS si: biseda të hapura në auditor, tutoriate për tema konkrete, bashkëpunim për workshope të ndryshme, etj.

Numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit; numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioriteteve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore; numrin e studentëve të shkëlqyer; numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen; numrin e studentëve që kanë përfutur bursa dhe numrin e atyre që kanë përfutur nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit; pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për

lëvizshmërinë e tyre; përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që diplomohen; një vlerësim të përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi;

Kreu A.10. – Të dhëna mbi studentët

Të dhëna statistikore për studentët aktivë të regjistruar në vitin akademik 2024-2025

Emërtimi i Programit të Studimit	Cikli i Programit të Studimit	Nr.studentësh të regjistruar	Nr.studentësh përsëritës
Art dhe Dizajn	Bachelor	259	11
Inxhinieri Ndërtimi	Bachelor	140	7
Arkitekturë dhe Dizajn Urban	Master i shkencave(PI)	599	13
Inxhinieri Ndërtimi me profile: a. Strukturë;	Master i shkencave	62	8
Arkitekture Dixhitale	Master profesional	11	na
Dizajn i Aplikuar	Master i shkencave	45	2
Planifikim dhe Menaxhim Urban	Master i shkencave(PI)	92	2
Planifikim Hapesinor dhe GIS	Master profesional	12	na
Administrim Biznesi	Bachelor	57	na
Menaxhim Mjedisor Urban	Master i shkencave	22	3

Administrim Biznesi	Master i shkencave	19	na
Shkenca Kompjuterike	Bachelor	271	3
Efëçencë Energjitike	Diplomë profesionale	14	na
Mirëmbajtje Rrjetesh Kompjuterike	Diplomë profesionale	17	na
Shkenca Kompjuterike	Master i shkencave	41	1
Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore	Master i shkencave	na	na
Arkitekturë dhe Planifikim Urban	Doktoratë	43	

Të dhëna statistikore për studentët e larguar në vitin akademik 2024-2025

Emërtimi i Programit të parë të studimit	Cikli i Programit të Studimit	Nr. studentësh të çregjistruar
Art dhe Dizajn	Bachelor	7
Inxhinieri Ndërtimi	Bachelor	7
Arkitekturë dhe Dizajn Urban	Master i shkencave(PI)	6
Inxhinieri Ndërtimi me profile: a. Strukturë;	Master i shkencave	2
Arkitekture Dixhitale	Master profesional	
Dizajn i Aplikuar	Master i shkencave	1
Planifikim dhe Menaxhim Urban	Master i shkencave(PI)	8
Planifikim Hapesinor dhe GIS	Master profesional	
Administrim Biznesi	Bachelor	2
Menaxhim Mjedisor Urban	Master i shkencave	
Administrim Biznesi	Master i shkencave	1
Shkenca Kompjuterike	Bachelor	7
Efëçencë Energjitike	Diplomë profesionale	3
Mirëmbajtje Rrjetesh Kompjuterike	Diplomë profesionale	1
Shkenca Kompjuterike	Master i shkencave	
Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore	Master i shkencave	
Arkitekturë dhe Planifikim Urban	Doktoratë	4

Kreu A.9. – Vlerësime dhe rekomandime të mundshme për MAS

Universiteti POLIS vlerëson bashkëpunimin me MAS si shumë pozitiv. Sugjerimi ynë është që Ministria të ushtrojë maksimalisht rolin e vet rregullator dhe të garantojë konkurrencë të barabartë mes IAL-ve.

PJESA B – Bordi i Akreditimit

Kreu B.1. Struktura Organizative

a) Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitet përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj.

POLIS ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet një sërë organesh, të tilla si njësitet akademike dhe kërkimore, njësitet administrative, por edhe kolegiale, të cilat veprojnë në përputhje me statutin, rregulloren dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.

POLIS përfshin një strukturë të integruar e cila përbëhet nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, të përmendura edhe në statut. Struktura organizative e Universitetit POLIS dallon 4 (katër) lloje të njësive organizative përbërëse:

1. Njësi kryesore që janë Fakultetet
2. Njësi bazë ku përfshihen departamentet dhe qendrat kërkimore;
3. Njësitë ndihmëse si laboratorë, studiot profesionale, etj;
4. Qendra ndër-departamentale për Studime Ndërdisciplinore Kërkimore dhe Inovacioni.

Siç shihet nga skema organizative e institucionit **Aneks 6 – Struktura Organizative** POLIS përbëhet nga 3 njësi kryesore dhe 9 njësi bazë (3 për secilën njësi kryesore), nga të cilat 6 departamente me natyrë akademike dhe 3 njësi të dedikuara tërësisht për kërkim.

Në përputhje me misionin dhe objektivat e veta, POLIS ka krijuar gjithashtu një qendër kërkimore ndërdisciplinare, përkatësisht Fabrika e Inovacionit (IF), e cila koordinon përpjekjet dhe nismat ndërmjet të gjitha njësive që lidhen me konceptet, teoritë, qasjet, metodologjitë, praktikën e zhvilluar në POLIS. Përveç kësaj, POLIS ka themeluar një numër organesh të pavarura (organe kolegjiale) që sigurojnë mirë funksionimin e institucionit. Organe të tilla kanë një fushë të qartë dhe përgjegjësi dhe janë përgjegjëse për aspekte të ndryshme të jetës akademike. Mund të përmendim Këshillin e Etikës, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Këshillimit për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës.

Kreu B.2. Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm

Plani buxhetor afatmesëm 2025-2028

Nr	Te ardhurat	Vlera 2025-2026	Vlera 2026-2027	Vlera 2027-2028
1	Te ardhurat nga tarifat e shkollimit	475 000	485 000	490 000
2	Te ardhura nga projekte dhe grante	40 000	42 000	45 000
3	Te ardhura të tjera	15 000	20 000	20 000
	Total	530 000	547 000	555 000

Nr	Shpenzimet	Vlera 2025-2026	Vlera 2026-2027	Vlera 2027-2028
1	Paga staf i brendshëm dhe i ftuar	322 000	335 000	350 000
2	Shpenzime administrimi	92 000	95 000	98 000
3	Investime	20 000	30 000	20 000
	Total	434 000	460 000	468 000

Kreu B.3. Të dhëna për realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës

Realizimi faktik i buxhetit të vitit 2024-2025

në 000 lekë

Nr	Te ardhurat	Vlera
1	Te ardhurat nga tarifat e shkollimit	436 870
2	Te ardhura nga projekte dhe grante	33 793
4	Te ardhura të tjera	7 615
	Total	478 278

Nr	Shpenzimet	Vlera
1	Paga staf i brendshem dhe i ftuar	315 845
2	Shpenzime administrimi	84 296
3	Investime	23 277
	Total	423 418

Plani i buxhetit të vitit akademik 2025-2026

në 000 lekë

Nr	Te ardhurat	Vlera
1	Te ardhurat nga tarifat e shkollimit	475 000
2	Te ardhura nga projekte dhe grante	40 000
3	Te ardhura te tjera	15 000
	Total	530 000

Nr	Shpenzimet	Vlera
1	Paga staf i brendshem dhe i ftuar	322 000
2	Shpenzime administrimi	92 000
3	Investime	20 000
	Total	434 000

Kreu B.4. Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore

Bashkëlidhur raportit gjeni të dhpërkatësisht në **Aneks 7 - Vërtetim shlyerje detyrime 2024- 2025).**

Kreu B.5. Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik

Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare.

Mobilitetet në kuadër të projekteve KA1 vazhdojnë të jenë pjesë e prioriteteve sic dhe është përcaktuar në Strategjinë e Ndërkmbëtarizimit të Universitetit POLIS.

ICM	Staff akademik	Staff Administrativ	Vendi
IGS Lyon, France	2	-	Lyon
Politecnico di Bari, Itali	-	2	Bari
University of Napoli "Federico II", Itali	3	-	Napoli
Universidad De Castilla La Mancha, Spain	1	-	Cuenca
Slovak University of Technology in Bratislava	2	-	Bratislava
Bauhuas University of Weimar	2	-	Weimar
University of Minhho	2	-	Minho
Polytechnic University of Castello Branco	3	-	Castello Branco
Blekinge Institute of Technology	2	-	Karlskrona
University of Ioannina	1	-	Ioannina

Tabela 1. Mobilitete stafi në kuadër të projekteve Exchange KA1

Në të njëjtën kohë stafi i Universitetit POLIS ka zhvilluar dhe një sërë mobilitetesh me qëllim trajnimin, workshop, apo takime të ndryshme menaxheriale, në kuadër të projekteve KA2 CBHE të cilat po implementohen në POLIS

Projekti	Staff akademik	Staff Administrativ	Vendi
SmartWB	2	-	Mostar
Stefora	2	-	Prishtine
Roaming	2	1	Prishtine
Pelmob	1	-	Podgorice
DGTRANS	4	-	Sarajeve
Intec	3	-	Podgorica
Intec	2	-	Split
Couture	2	-	Prishtine
Homodigitalis	3	-	Sarajeve
Uprun	2	-	Patra
Uprun	2	-	Mitrovice
IPA Adrion	2	1	Zare
IPA Adrion	1	1	Patra
POLIS- IBCM	10	-	Mitrovice
ReZEB	2	-	Qipro
ReZEB	4	-	Madrid
BAUHAUS4EU	22	-	Weimar (6); Castello Branco (11) Katowice (1) Karlskrona (2) Bergamo (2)

Tabela 2. Të dhëna për mobilitetin e stafit në kuadër të projekteve KA2 CBHE

Mobiliteti i studentëve

Dhënia e mundësisë që studentët të jenë pjesë e mobiliteteve dhe të realizojnë një periudhë studimi (një semestër) në niversitetet evropiane, është një tjetër prioritet i Universitetit POLIS. Gjatë vitit akademik 2024-2025, lëvizja e studentëve është si më poshtë :

Mobilities	Outgoing
Polytechnic University of Bari	2
Anhalt University of Applied Sciences	8
Slovak University of Technology in Bratislava	2
University Federico II in Naples	1
University of Aveiro	2
Lublin University of Technology	2
University of Maribor	2
Universidad De Castilla La Mancha	2
University of Molise, Italy	7
University of Minho	3
Blekinge Institute of Technology	2
Polytechnic University of Castello Branco	3

Bauhaus University of Weimar	6
University of Ioannina	1

Tabela 3. Të dhëna për mobilitetin e studentëve

Kreu B.6. Konformiteti me Kodin e Cilësisë

Të dhëna për plotësimin e standarteve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjedise didaktike, kërkimore, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin.

Sigurimi i cilësisë ka qenë një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së institucionit që prej themelimit të tij. POLIS synon të krijojë një kulturë të fortë mes komunitetit të tij, prandaj njësia e krijuar NJBSC, ka mbështetje të fortë dhe i është dhënë autonomi e plotë.

Njësia e ka zgjeruar vazhdimisht fushën e saj të veprimit dhe aktualisht mbulon jo vetëm procesin e mësimdhënies, por edhe funksionet kërkimore dhe administrative. POLIS ka marrë vazhdimisht reagim pozitiv nga kontrole të ndryshme të cilësisë dhe procese akreditimi në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, por të qenit autokritik është një parim thelbësor në përqasjen institucionale, ndaj rekomandimet e NJBSC janë një informacion i vyer për rishikimin e organizimit të strukturës institucionale apo programeve akademike me qëllimin final arritjen e objektivit të POLIS: të sigurojë ekselencë në mësimdhënie dhe të plotësojë standardet më të larta akademike. Kjo vëmendje e posaçme ndaj cilësisë është reflektuar dhe në korrektesën maksimale të institucionit ndaj të gjitha proceseve të vlerësimit të cilësisë, jo vetëm atij të brendshëm por dhe akreditimeve institucionale dhe programe konform afateve të parashikuara në ligj.

Të dhëna të detajuara për të gjitha kategoritë e akreditimeve institucionale dhe ato të programeve gjenden të listuara në linkun si vijon:

<https://universitetipolis.edu.al/akreditimi/>

Garantimi i cilësisë është një proces i vazhdueshëm dhe për POLIS mbetet një objektiv që cilësinë ta kthejë në kulturë institucionale.

ANEKSE

- Aneks 1 - Aktivitete të zhvilluara Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn
- Aneks 2 - Aktivitete të zhvilluara Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban
- Aneks 3 - Aktivitete të zhvilluara Fakulteti Kërkim dhe Zhvillim
- Aneks 4 - Raporti Vjetori i NJBSC-së 2024-2025
- Aneks 5 - Planet Mësimore 2024-2025
- Aneks 6 - Struktura Organizative 2024-2025
- Aneks 7 - Vërtetim shlyerja e detyrimeve 2024-2025